



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 56 Datë 5.10.2011

PER

MIRATIMIN E VLERES SE MBIKQYRJES DHE KOLAUDIMIT PER OBJEKTIN
RIKONSTRUKSION I SHKOLLES "RAQI QIRINXHI"

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim raportin e paraqitur nga ekzekutivi i Bashkisë Korçë «Për miratimin e vlerës së mbikqyrjes dhe kolaudimit për objektin rikonstruksion i shkollës « Raqi Qirinxi », në zbatim të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», ligjit nr 10355 datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", e ndryshuar, ligjit 10450 datë 14.7.2011 "Për buxhetin e vitit 2011", Udhëzimit nr. 4 datë 27.1.2011 "Për zbatimin e buxhetit 2011", udhëzimi nr. 3 datë 15.2.2001 "Për mbikqyrje dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit i ndryshuar" si dhe VKM nr. 444 datë 5.9.1994 "Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

VENDOSI

1. Të miratojë vlerën e mbikqyrjes në vlerën 428,525 lekë dhe vlerën e kolaudimit në vlerën 38,000 lekë.
2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë me këtë strukturë buxhetore :

PAKESOHET	00	04980	05	Art. 6090000	-466,525 lekë
SHTOHET	00	09230	05	Art. 2310000	+466,525 lekë (Bashkia)
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike si dhe Drejtoria e Projektimit Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari

Ilirjan PENDAVINJI